

PROJEKTET NË ZBATIM THIRRJA E 4^{të}					
GRANTMARRËSIT ORGANIZATA JO FITIM-PRURËSE					
Nr.	Organizata	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
1	Albania Community Assist - ACA	Teatri i rrugës nëpër Shqipëri	Projekti synon të sjellë ndryshimin nëpërmjet nxitjes së pjesëmarrjes së komunitetit në vendimarrje; advokimit për çështje të rëndësishme për komunitetin; forcimit e rritjes së nivelit të demokracisë vendore nëpërmjet artit si një mjet tërheqës për komunitetin, veçanërisht duke përfshirë të rinjtë për tematika të mjedisit, transparencës, llogaridhënies dhe korrupsionit. Objektivi kryesor është të sensibilizojë dhe ndërgjegjësojë komunitetin, veçanërisht 800 të rinj, nëpërmjet Teatrit të Rrugës dhe paraqitjes online të aksioneve rinore në qytetet Berat, Korçë, Pogradec dhe Vlorë.	9	Bashkitë Berat, Korçë, Pogradec dhe Vlorë
2	EESTEC LC Tirana	Aplikacion për forcimin e demokracisë vendore	Projekti synon të bëjë më të thjeshtë dhe të përditësuar marrjen e informacionit për procedurat që ndjek Bashkia e Tiranës për të gjithë qytetarët që jetojnë në qytetin e Tiranës. Objektivi kryesor është realizimi i një loje sa më tërheqëse që synon të informojë qytetarët për funksionin dhe kompetencat e qeverisë vendore.	9	Bashkia Tiranë
3	Grupi Lokal i Veprimit Integrimi	Advokaci komunitare për shërbime ndaj moshës së tretë në Bashkinë Dibër	Projekti synon ngritjen e një qendre multifunksionale për moshën e tretë në qytetin e Peshkopisë. Objektivat kryesore janë angazhimi i komunitetit të 4 Njësive Administrative për të advokuar nëpërmjet një peticioni dhe nëpërmjet medias për të ngritur një qendër ditore për të moshuarit.	8	Bashkia Dibër

4	Gjelbërimi 2000	Zëri yt = Zëri ynë	Projekti synon të përfshijë komunitetin në vendim-marrje, buxhetimin me pjesëmarrje, vendosjen e prioriteteve, zbatimin e buxhetit të Bashkisë Selenicë dhe monitorimin e investimeve në sektorin e bujqësisë. Objektivat kryesorë janë monitorimi për 10 muaj mbi investimet në fushën e bujqësisë si dhe të llojë për ritjen e buxhetit të bujqësisë me 20% për vitin 2019.	12	Bashkia Selenicë
5	Instituti i Studimeve Sociale dhe Humane	Tirana - Qytet bashkëpunues: pjesëmarrja qytetare në realizimin e planit urbanistik TR2030	Projekti synon të vendosë praktika të aktivizmit qytetar për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e politikave urbane në qytetin e Tiranës me fokus hapësirat e përbashkëta dhe publike. Objektivat kryesorë janë: mobilizimi aktivist i rreth 600 qytetarëve nga 6 qendrat urbane të Tiranës rreth mbrojtjes dhe shfrytëzimit kolektiv të hapësirave të përbashkëta dhe publike në lagjet e tyre; përpilimi i 6 planeve konkrete për jetësimin e hapësirave të përbashkëta dhe publike përmes pjesëmarrjes demokratike të qytetarëve në nivel lokal; sigurimi i fondeve për jetësimin e hapësirave të përbashkëta dhe publike në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës përmes formës së asambleve pjesëmarrëse qytetare në vendim-marrjen në nivel lokal.	12	Bashkia Tiranë
6	Milieukontakt Albania	Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane në bashkitë Krujë, Përmet, Sarandë	Projekti synon të përmirësojë gjendjen aktuale të shërbimit të pastrimit në 3 bashki dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve për mbajtjen pastër të qytetit ku jetojnë. Objektivat kryesorë janë: ngritja e kapaciteteve monitoruese të organizatave lokale dhe të aftësive të tyre lidhur me menaxhimin e mbetjeve; monitorimin e realizimit të cilësisë së shërbimit të pastrimit për 3 bashki bazuar në kushtet e kontratave; ndërgjegjësimin dhe ritjen e rolit aktiv të qytetarëve në mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij.	12	Bashkitë Krujë, Përmet, Sarandë

7	Misionarët e të Drejtave Sociale (MDSK)	Ngritja dhe funksionimi i komisionit qytetar	Projekti synon të krijojë një mekanizëm transparent dhe bashkëqeverisës për ndërgjegjësimin, forcimin e kapaciteteve, dhe rritjen e përfshirjes së komunitetit në vendimarrjen lokale nëpërmjet Komisionit Qytetar. Objektivi kryesor i tij është ngritja dhe funksionimi i Komisionit Qytetar brenda 9 muajve.	9	Bashkia Poliçan
8	North Green Association	Gjurmë të gjelbërta për Dibrën	Projekti synon të kontribuojë në pëmirësimin e praktikës së menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Dibër dhe ndërgjegjësimin mbi ndotjen e lumit Drin. Objektivi kryesor është të evidentojë, advokojë dhe llobojë mbi dëmin mjedisor që shkaktojnë mbetjet urbane në rrjedhën e lumit Drin.	13	Bashkia Dibër
9	Qendra e Këshillimit të Grave dhe Shërbimeve Sociale - Kukës	Iluzioni i barazisë gjinore në vendimarrjen vendore	Projekti synon të ndërgjegjësojë veprimin e qytetarëve, institucioneve përgjegjëse për respektimin e barazisë gjinore me masa konkrete dhe ndryshimi i situatës në sfidat vendore. Objektivat kryesorë janë: advokimi në Bashkitë Kukës, Tropojë dhe Has, që në 30% të vendeve të punës duhet të jenë emëruar gratë; identifikimi i vendeve të lira dhe atyre ku pozicioni duhet të ishte i zënë nga një grua dhe lobimi për emërimin e grave.	12	Bashkitë Has, Kukës dhe Tropojë
10	Qendra Fokus "Në ndihmë të fëmijëve"	Me familjen në mendje	Projekti synon të kontribuojë në transformimin e jetës së fëmijëve si kujdestarë të prindërve që vuajnë nga sëmundje mendore dhe si përfitues të shërbimeve vendore për kujdes shëndetësor, social dhe arsimor. Objektivat kryesorë janë: të monitorohet cilësia e shërbimeve mjekësore dhe mbështetjes ndaj fëmijëve – kujdestarë dhe familjeve të neglizhuara në bashkitë e Tiranës, të Elbasanit, të Vlorës dhe të Shkodrës; të advokohet për ndryshimin e praktikave administrative dhe institucionale në fushën e shërbimeve mjekësore, edukuese dhe mbrojtjes sociale për funksionimin e këtyre shërbimeve në popullatën e bashkive të përfshira.	15	Bashkitë Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Shkodër

11	Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim (EDEN)	T'u japim zë qytetarëve – stimulimi i pjesëmarrjes publike mjedisore në Tiranë	Projekti synon të hulumtojë dhe të bëjë publik procesin e ndjekur për dhënien e konçensionit për incenerimin e mbetjeve në Tiranë si dhe të stimulojë reagim e debat publik bazuar në analiza e informacione transparente. Objektivat kryesorë janë: mobilizimi dhe informimi i qytetarëve për procesin e ndjekur për dhënien me konçension të incineratorit të Tiranës; realizimi dhe bërja publike e një analizë krahasimore eko-socio-ekonomike të incenerimit vs riciklimit, si një mjet advokimi për menaxhimin e mbetjeve urbane në kryeqytet.	12	Bashkia Tiranë
12	Qendra për Kërkim Bashkëpunim dhe Zhvillim	Unë vendos për një të ardhme pa merkur!	Projekti synon të ndikojë në vendimmarrjen e qeverisjes vendore për të marrë masa për largimin e banorëve nga zona ish-uzina e PVC-së. Objektivat kryesorë janë: të llojë me qëllim zhvendosjen e banorëve nga zona e ish-uzinës së PVC-së; të mobilizojë banorët e zonës së PVC-së për të qenë pjesëmarrës dhe aktivë në vendimmarrjen për të ndryshuar kushtet e jetesës.	14	Bashkia Vlorë
13	Qendra Sociale në Ndihmë të Njerëzve në Nevojë - Fushë Arrëz (QSNNN)	Angazhimi i komunitetit për një mjedis më të pastër	Projekti synon përmirësimin e situatës dhe rritjen e buxhetit për çështjet mjedisore në Bashkinë e Fushë-Arrëzit, përmes nxitjes së angazhimit qytetar dhe pjesëmarrjes aktive të komunitetit. Objektivi kryesor është mobilizimi i 200 banorëve në Bashkinë Fushë-Arrëz në realizimin e një fushate advokimi për të ndikuar në prioritetet e qeverisë lokale në rritjen e buxhetit për çështjet mjedisore, përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve dhe pyjeve.	12	Bashkia Fushë-Arrëz
14	Qendra Trajnim, Edukim dhe Demokraci (TED)	Forumi i politikave integruese për bashkinë time	Projekti synon që nëpërmjet forumeve të hapura të mundësojë nxitjen e llogaridhënies nga qytetarët tek të zgjedhurit dhe emëruarit vendor nëpërmjet debatimit dhe paraqitjes së mendimit ndryshe. Objektivat kryesorë janë: fuqizimi i mendimit kritik dhe llogaridhënies për 500 persona nëpërmjet diskutimeve publike; monitorimi dhe adresimi i të paktën 6 problematikave në nivel lokal dhe qëndror për çështje në interes të komunitetit.	9	Bashkitë Bulqizë, Korçë, Tiranë

15	Qendra T'REJA	Përmirësimi i kushteve të jetesës për persona që jetojnë në situatë rruge	Projekti synon të identifikojë individët/familjet në situatë rruge dhe referimi tyre pranë qendrave sociale të administruara nga Bashkia Tiranë. Objektivat kryesorë janë: nxitja e Bashkisë Tiranë për përfshirjen e rasteve në një nga programet sociale të strehimit me qëllim krijimin e praktikës për rastet e tjera që do të ndiqen nga vetë Bashkia në të ardhmen; advokim për krijimin e një qendre rezidenciale, për personat në situatë ekstremisht vulnerabël, e cila do të mbështesë dhe përgatisë ata për t'ju kthyer jetesës normale	12	Bashkia Tiranë
16	Shoqata "Mendime dhe Iniciativa të Lira"	Rinia i njeh dhe di si t'i kërkojë të drejtat qytetare	Projekti synon të advokojë pranë strukturave të pushtetit vendor për të hartuar dhe zbatuar politika të drejta dhe të qëndrueshme për rininë dhe konkretisht, përcaktimin e një zëri të veçantë për rininë në buxhetin e Bashkisë Lushnjë për vitin 2019, që do të mundësonte krijimin dhe funksionimin e një Qendre Rinore publike, ku të rinjtë mund të shpalosin talentet, të organizojnë aktivitete kulturore rekreative, sportive me një kalendar vjetor. Objektivi kryesor është angazhimi i 300 të rinjve artistë në veprimtari artistike promovuese dhe advokuese për përcaktimin e një zëri të veçantë për rininë në buxhetin e Bashkisë Lushnjë për vitin 2019 që do të mundësonte krijimin dhe funksionimin e një Qendre Rinore publike.	12	Bashkia Lushnjë

17	Shoqata “Miq të Korçës”	Monitorim, transparencë dhe llogaridhënie për ruajtjen, mirëmenaxhimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm në ekosistemet e Prespës dhe Ohrit	Projekti synon të reduktojë fenomenet negative të shkatërrimit të pyjeve në ekosistemet e Prespës e Ohrit, përmes angazhimit të shoqërisë civile për zhvillimin e modeleve inovative të partneritetit bashki-komunitet, ndërgjegjësimin të publikut e medias, përmirësimit të menaxhimit të pyjeve nga bashkitë e reja dhe zhvillimit të kapaciteteve të monitorimit për transparencën e llogaridhënien. Objektivat kryesorë janë: zhvillimi i një modeli inovator të partneritetit bashki-komunitet për ruajtjen dhe mirëmenaxhimin e pyjeve në ekosistemet Prespë-Ohër, të cilat do mundësojnë përfshirjen e komuniteteve në këtë proces; krijimi i Koalicionit për Mbrojtjen e Pyjeve nga organizata të shoqërisë civile të rajonit, veprimtaria e të cilit do synojë të nxisë transparencën e llogaridhënien e qeverisjes vendore.	15	Bashkitë Devoll, Pogradec, Pustec
18	Shoqata Kulturore Shqiptare "Ress - Egnatia"	Elbasani përjetësisht mes sfidave të historisë dhe përditshmërisë - qytetari dhe arti në veprim	Projekti synon të promovojë përmes artit teatroz zgjidhjen e nevojave jetike, specifike, të qytetarëve të Lagjes Kala dhe atyre të NJA-së Bradashesh nga ana e Bashkisë Elbasan, e zgjeruar pas ndarjes së re administrative. Objektivi kryesor është realizimi i dy shfaqjeve teatrore për të rritur ndërgjegjësimin e banorëve dhe për të nxitur përgjegjshmërinë dhe përfshirjen e Bashkisë së Elbasanit në veprime konkrete për zgjidhjen e problematikave të targetuara.	12	Bashkia Elbasan dhe NJA Bradashesh
19	Shoqata për Ruajtjen e Vlerave e Zhvillim	Rrjeti komunitar në vendimmarrje, armë e fuqishme për mbrojtjen nga zjarret	Projekti synon të nxisë banorët e zonave të prekura për t'u organizuar në një Rrjet të përbashkët (Rrjeti Komunitar Kundër Zjarreve), i cili adreson problematikën e komunitetit pranë Bashkisë Korçë dhe ndikon në zgjidhjen sa më shpejt të mundur duke synuar të bëhen pjesë e vendimmarrjes pranë institucioneve vendore. Objektivat kryesorë janë: formimi dhe fuqizimi i një Rrjeti prej 18 anëtarësh në fshatrat Panarit, Voskopojë, Lekas, Dardhë, Shtyllë e Vithkuq, të cilët do të advokojnë për ruajtjen e pyjeve nga zjarret; rishikim të Planit të Masave ekzistent të Bashkisë Korçë duke përfshirë problemet dhe shqetësimet e ngritura nga komuniteti.	12	Bashkia Korçë

20	Shoqata SOROPTIMIST	Murimi i historisë së një qyteti	Projekti synon të promovojë përmes dokumentarit të një lëvizjeje qytetare e cila krijoi një frymë ndërgjegjësimiti mbi ruajtjen e trashëgimisë kulturore të një prej qyteteve me historinë më të lashtë. Ajo adreson betonizimin e qyteteve nëpërmjet një dokumentari 48 minutësh, duke ballafaquar konfliktet midis qeverisjes vendore dhe publikut qytetar. Objektivi kryesor është nxitja e debateve të qytetarëve dhe aktivistëve për të ndjekur çështjet e rëndësishme për qytetin dhe vendbanimet e tyre në rrugë ligjore nëpërmjet dokumentarit.	5	Bashkitë Tiranë, Durrës, Fier (Apolloni), Berat, Shkodër, Korçë
21	Shpresë për ne	Shpresë për ne - Lëviz për të ardhmen!	Projekti synon të punojë për forcimin, njohjen, promovimin dhe respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, duke bërë pjesë të vendimmartjes në bashkinë Vlorë prindërit dhe familjet, të cilët kanë fëmijë dhe persona PAK. Objektivat kryesorë janë: realizimi dhe vendosja e jo më pak se 10 rampave për të aksesuar dhe lehtësuar personat PAK në frekuentimin dhe përdorimin e institucioneve kryesore arsimore, shëndetësore dhe të shërbimeve sociale dhe administrative në Bashkinë e Vlorës; sigurimi i transportit për fëmijët që frekuentojnë të vetmen shkollë për fëmijët PAK në Vlorë; ndërtimi i një palestere për fëmijët që frekuentojnë Shkollën Speciale PLM, e cila të jetë e hapur dhe për komunitetin përreth.	12	Bashkia Vlorë
22	Well Point-Kujdes për të gjithë	Monitorimi dhe vlerësimi i situatës higjeno-sanitare në institucionet arsimore publike në Bashkinë Shkodër	Projekti synon të vlerësojë situatën higjeno-sanitare në institucionet arsimore parauniversitare, për të forcuar llogaridhënien e qeverisjes vendore në zbatimin e ligjit që lidhet me të drejtat e fëmijëve. Objektivat kryesorë janë: vlerësimi i situatës higjeno-sanitare në institucionet parauniversitare nëpërmjet një monitorimi korrekt të indikatorëve themelorë për arritjen e këtij qëllimi në 38 shkollat e Bashkisë Shkodër; formulimin e rekomandimeve për Bashkinë Shkodër që synojnë përmirësimin e kushteve higjeno sanitare me qëllim sigurimin e një mjedisi të përshtatshëm në 38 shkollat.	9	Bashkia Shkodër

23	Zëri Qytetar	RIK është zëri ynë	Projekti synon të garantojë pjesëmarrjen e banorëve të Bashkisë së Lushnjës në procesin e vendimmarrjes. Objektivat kryesorë janë angazhimi i qytetarëve të 5 Njësive Administrative të Bashkisë Lushnjë në identifikimin e problemeve publike dhe gjetjen e zgjidhjeve më të përshtatshme e të qëndrueshme për buxhetin e 2019 nëpërmjet Kartës së Zërit Qytetar.	12	Bashkia Lushnjë
----	--------------	--------------------	--	----	-----------------

PROJEKTET NË ZBATIM THIRRJA E 4^{të}

GRANTMARRËSIT INDIVIDË

Nr.	Individi	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
24	Ardian Hoti	Praktika studentore e gazetarisë në shërbim të problematikave qytetare të lëna pas dore nga pushteti vendor	Projekti synon të kontribuojë për një qeverisje më të përgjegjshme dhe për një demokraci më të zhvilluar vendore, nëpërmjet fuqizimit të zërit të qytetarëve të thjeshtë në zonat urbane dhe ato periferike. Objektivat kryesorë janë: ndërtimi i një portali me përmbajtje profesionale; publikimi në këtë portal i shkrimeve, kronikave, reportazheve dhe dokumentarëve në lidhje me problematikat e komuniteteve.	12	Bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë
25	Bepin Kolvataj	Shkodra mbi dy rrota	Projekti synon të krijojë kushte sa më të përshtatshme infrastrukturore për pedalim. Objektivat kryesorë janë: brenda 12 muajve do të llobohet për lirim të hapësirave kushtuar lëvizjes me biçikletë, duke eliminuar parkimet e automjeteve; të kontribuojë në shtimin e korsive të reja, për të gjitha projektet e rrugëve që do të zbatohen në vazhdimësi nga pushteti vendor, por gjithashtu edhe duke vënë dorë në ato ekzistueset ku paraqitet nevoja.	12	Bashkia Shkodër
26	Blerim Ribaj	Përmirësimi i bashkëveprimit të punës së qeverisjes vendore me grupet e interesit në transportin publik	Projekti synon të minimalizojë numrin e taksive të palicënuara në qytetin e Vlorës. Objektivat kryesorë janë: grupi i interesit të shoferëve të taksive do të advokojë me bashkinë e Vlorës që të ushtrojë kompetencat e saj në drejtim të kontrollit të territorit për taksitë ilegale; Bashkia e Vlorës rrit numrin e vend-qëndrimeve për shërbimin publik të taksive.	8	Bashkia Vlorë

27	Elisa Gjerani	Shkolla ime	Projekti synon të rrisë presionin qytetar ndaj pushtetit vendor (Kamëz) për përmirësimin e infrastrukturës në institucionet e arsimit parauniversitar. Objektivat kryesorë janë: ngritja e një faqeje në median sociale për monitorimin e gjendjes në shkollat e Kamzës dhe advokimin për ndryshimin e situatës nëpërmjet 24 shkrimeve dhe 8 reportazheve; realizimi i 8 takimeve me Borde Prindërishe dhe realizimi i një forumi me nxënësit për identifikimin e problematikave dhe nxitjen e tyre në lobimin ndaj të zgjedhurve vendorë për investimet në sektorin e arsimit.	12	Bashkia Kamëz
28	Emiljano Hajna	Përmirëso lagjen time	Projekti synon të krijojë një platformë online që lehtëson komunikimin e drejtpërdrejtë për problemet lokale midis qytetarëve dhe administratës së qytetit të Sarandës. Objektivi kryesor është të ngrihet një platformë për qytetarët open source platform për të raportuar problematikat e qytetit të Sarandës.	9	Bashkia Sarandë
29	Granit Sokolaj	Monitorimi i shërbimeve të bashkive: Tregjet e hapura, si shkak për cënimin e sigurinë ushqimore	Projekti synon të advokojë nëpërmjet medias për përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare të 10 tregjeve të kafshëve të gjalla. Objektivat kryesorë janë: të monitorojë në terren 10 tregjet e kafshëve në njësitë administrative: Milot, Tapizë (Krujë), Rrogozhinë, Çerravë (Korçë), Qukës (Librazhd), Cërrik, Bushat (Shkodër), Fier, Lushnjë, Divjakë; të zhvillojë fushata advokuese për përmirësimin e tregjeve të hapura nëpërmjet të paktën 20 artikujve/reportazheve për të përmirësuar kushtet higjieno-sanitare.	9	10 njësitë administrative: Milot (Kurbini), Tapizë (Krujë), Rrogozhinë, Çerravë (Korçë), Qukës (Librazhd), Cërrik, Bushat (Shkodër), Fier, Lushnjë, Divjakë

30	Klea Nasto	Art ATTACK!	Projekti synon të rrisë pjesëmarrjen e të rinjve në procesin e vendim-marrjes vendore, nëpërmjet ARTIT. Objektivi kryesor i projektit është krijimi i mundësive dhe hapësirave, për të paktën 150 të rinj në përfshirjen që të ushtrojnë presion ndaj bashkisë nëpërmjet artit.	8	Bashkia Pogradec
31	Lysiena Topi	Demoart_Korça	Projekti synon që nëpërmjet artit të mund të kultivojmë tek të rinjtë e Korçës predispozitën për të qenë qytetarë aktivisht pjesëmarrës në të gjitha aspektet e hapësirës demokratike dhe publike lokale mbështetur në gjykim kritik konstruktiv. Objektivat kryesorë janë: ndërgjegjësimi i të paktës 200 të rinjve të qytetit të Korçës mbi rëndësinë e demokracisë lokale duke motivuar reflektimin e tyre mbi të dhe të shprehurin e saj nëpërmjet artit vizual (vizatime, piktura, karikatura, skulptura, instalacione, video, dizajn, etj.); kultivimin e gjykimit kritik dhe frymës llogari kërkuese ndaj institucioneve publike lokale tek të paktën 200 të rinj të qytetit të Korçës; kultivimi i vullnetit për të qenë aktivisht pjesëmarrës në hapësirën publike tek të paktën 200 të rinj të qytetit të Korçës.	6	Bashkia Korçë
32	Nensi Dragoti	Fuqizimi i Rinisë në qytetin e Gramshit (Advokim - Përfshirje - Zhvillim)	Projekti synon që bashkia e Gramshit të prioritetizojë çështjet e të rinjve duke dedikuar buxhet në vitin 2019 për të mbështetur prioritetet e tyre. Objektivat kryesorë janë: fuqizimi i 30 të rinjve dhe ngritja e kapaciteteve të tyre advokuese në bashkinë e Gramshit; advokimi me të rinjtë për alokimin e një zëri të veçantë në buxhetin e Bashkisë për vitin 2019, kushtuar aktiviteteve për të rinjtë dhe sportit.	10	Bashkia Gramsh

33	Nikollaq Terezi	Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e të rinjve në përcaktimin e politikave vendore për mirë administrimin e infrastrukturës në shkollat e arsimit parauniversitar	Projekti synon të fuqizojë aftësitë advokuese të nxënësve për evidentimin dhe zgjidhjen e problemeve të infrastrukturës në shkollat e Njësisë Bashkiake Nr.5. Objektivat kryesorë janë: advokimi nëpërmjet nxënësve të tre shkollave të mesme për përcaktimin e prioriteteve për investim; monitorimi i punës së shkollave, Njësisë Bashkiake Nr.5, Bashkisë Tiranë duke angazhuar grupet e punës përmes aktivizmit, veprimtarive online dhe ndjekjes administrative të problemit.	6	Bashkia Tiranë - Njësia Bashkiake nr. 5
34	Ogerta Ujkashi	Pa zhurmë	Projekti synon të nxisë bashkinë dhe Këshillin Bashkiak të hartojë plane dhe nisma për të reduktuar dhe parandaluar efektet e dëmshme të ekspozimit ndaj zhurmave akustike urbane të çliruara nga automjetet. Objektivi kryesor është advokim nëpërmjet hartimit të një dokumenti politikash dhe një fushate ndërgjegjësuese për të përfshirë 20.000 qytetarë në nismën për të zëvendësuar boritë me ajër me ato elektrike.	9	Bashkia Tiranë
35	Rivelino Ismalaj	Hapësira publike të domosdoshme	Projekti synon të angazhojë të rinjtë e Kurbinit për të advokuar me Bashkinë e Kurbinit për krijimin e hapësirave publike sportive për të rinjtë. Objektivat kryesorë janë: futja dhe planifikimi i hapësirave publike në buxhetin e ardhshëm të këshillit bashkiak; fillimi për lirim ose rindërtimin minimalisht të një hapësire publike, nga ana e pushtetit vendor brenda 6 muajve.	6	Bashkia Kurbin

36	Silvio Meka	Arti, zëri i të rinjve për ndryshim në demokracinë vendore	Projekti synon ndërgjegjësimin e organeve të qeverisjes vendore nëpërmjet artit, për të dëgjuar të rinjtë, si dhe përmirësimi i situatës së të rinjve nëpërmjet reagimit të pushtetit vendor në financimin e dy problematikave për secilën nga tre NJA. Objektivat kryesorë janë: përgatitja dhe vendosja e tre instalacioneve në tre NJA; advokimi për adresimin e nevojave të të rinjve nëpërmjet ekspozitës së fotove si mjet ushtrimi presioni ndaj bashkisë Devoll.	7	Bashkia Devoll
37	Valdrin Asani	Arti dhe inovacioni si mënyra alternative për të promovuar demokracinë vendore	Projekti synon të nxisë të rinjtë/ nxënësit e shkollave të mesme dhe studentët, në qytetin e Durrësit dhe Tiranës të jenë aktiv në proceset politike, nëpërmjet artit. Objektivi kryesor ka të bëjë me organizimin e debateve me rreth 300 gjimnazistë dhe studentë të Durrësit dhe Tiranës, për rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve për të ndryshuar politikën, duke përdorur dramën si një mjet për të përfshirë të rinjtë.	3	Bashkitë Durrës dhe Tiranë
38	Vilson Shehu	Kult-Ura	Projekti synon të përmirësojë qeverisjen vendore në fushën e kulturës dhe rinisë në bashkinë e Urës Vajgurore duke mundësuar krijimin e hapësirave publike për aktivitete kulturore dhe edukuese dhe rritjen e fondeve për financimin e tyre. Objektivat kryesorë janë: monitorimi i buxhetit dhe financimeve në fushën e kulturës dhe artit nga bashkia me fokus rininë gjatë 15 muajve; realizimi i aktiviteteve adovokuese dhe përmirësimi i buxhetit bashkisë për kulturën, rininë për 2018 dhe rritja e buxhetit për 2019.	15	Bashkia Ura Vajgurore